



Nr. i Protokollit: 04/ 683

29.12.2022

Rahovec

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASH-it Nr.05/2015, Për Normativ mbi Kuadrin Arsimit Profesional, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e vendit të lirë të punës me kuadër profesional arsimor, për vitin shkollor 2022/2023

1. IAAP"Selajdin Mullaabazi-Mici" në Rahovec.

Një mësimdhënës/e për lëndët e Ekonomisë, me 17 orë mësimi në javë, për kohë të caktuar.

Kushtet për konkurim:

- Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas U.A. 05/2015, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin e Arsimit Profesional, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.
- Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkangjitur dokumentet përkatëse, në zyrat e DKA-së.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e noterizuar të diplomës së fakultetit të kryer,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime

Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>.

Lista pritëse:

Kandidatët e cilët grumbullojnë më shumë se **59 pikë**, hynë në Listën Pritëse si kandidat fitues dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë, pozitë të lirë, Mësimdhënës për Lëndët e Ekonomisë, kanë të drejtë të punësohen.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data, 30.01.2023 dhe zgjatë 8 ditë kalendarike dhe atë deri më datë, 08.02.2023



Avni Morina, Drejtor